

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetar i trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit H. R., nga ..., Komuna e V., të cilin sipas autorizimit e mbron avokatja S. M., nga ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ dhe veprës penale të përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.192/2014, të datës 19 dhjetor 2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 6 korrik 2016, mori dhe publikisht shpalli dhe në këtë datë e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri H. R., nga babai M. dhe nëna Z., e lindur A., i lindur më ..., në fshatin S., Komuna e V., ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i ... fëmijëve, me punë të përkohshme në Z., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin ..., më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse në kohë të pavërtetuar më parë në mënyrë të paautorizuar në shtëpinë e tij në fshatin S., Komuna e V., në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët ka siguruar dhe mbajtur në pronësi armë të zjarrtë edhe atë një revole "...", ... mm, me ... fishekë, të të njëjtit kalibër, me numër serik ..., e që edhe më datën ... 2014, e njëjta armë i sekuestrohet nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Viti,

- me këtë ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

II.

Sepse më datën ... 2014, rreth orës ... minuta, në fshatin S., Komuna e V., në një aheng familjar, duke shkelur ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në mënyrë të paaautorizuar ka përdorë armën e zjarrit e llojit "...", ... mm, me ... fishekë të të njëjtit kalibër, me numër serik ..., e që ka shtënë tri herë në ajër, e që edhe më pastaj arma e lartpërmendur dhe gëzhojat i sekuestrohen nga ana e oficerëve të Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Viti,

- me këtë ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 69, 73, 74 dhe 75 të KPRK, si dhe neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të pandehurit H. R., i shqipton :

Për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, ndaj të pandehurit H. R., shqiptohet

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ndaj të pandehurit H. R., i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në afat prej 1 (një) muaji, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Ndërsa, për veprën penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, i shqiptohet

DËNIMI ME KUSHT

Ashtu që ndaj të pandehurit H. R., shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej 1 (një) viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Konfiskohet arma e zjarrit e markës "...", kalibri ... mm, me numër serik

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 19 dhjetor 2014 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit ndaj të pandehurit H. R., nga ..., Komuna e V., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale është mbajtur më datën ... 2016 dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar, i pandehuri H. R., ka deklaruar e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet, duke shtuar se e pranoi fajësinë për kryerjen e këtyre vepra penale.

2. Vlerësimi pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit, avokatës S. M., ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësen e tij, avokatën S. M.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Përveç këtyre, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri H. R., e ka pranuar fajësinë për kryerjen e këtyre vepra penale gjatë të gjitha fazave të procedurës penale.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri H. R., me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin H. R., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njejtat është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njejtë, siç e ka pranuar edhe vetë, ditën, vendin dhe në kohën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me dashje dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët e ka përdorur armën e zjarrit të cekur në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të cilën edhe e ka poseduar dhe mbajtur në pronësi pa leje valide dhe pa autorizim.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të pandehurin H. R., t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së lartcekur.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të pandehurit H. R., kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73, 74 dhe 75 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka zbutur dënimin për veprën penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimit (duke i shqiptuar të pandehurit dënim me kusht), është fakti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar. Kjo është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur me rrethanat tjera të shënuara më poshtë dhe duke u bazuar në nenin 75 të KPRK (zbutja e dënimit), tregon se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Në nenin 52 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se “dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, ndërsa për veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 1 i KPRK, është parashikuar dënimi me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet burgim. Andaj, duke në faktin se në këtë çështje penale është zbatuar neni 75 i KPRK, që i referohet zbutjes së dënimit, për shkak të pranimin të fajësisë nga i pandehuri, kryetari i trupit gjykues ka vlerësuar se duke i marrë për bazë edhe rrethanat e shënuar më poshtë, është e arsyeshme që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënimi me kusht për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi.

Përveç faktit se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, si rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se jam penduar për kryerjen e këtyre veprave penale; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është i martuar dhe është prind i ... fëmijëve; sjelljet e tij të mira gjatë shqyrtimit fillestar; se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë më ndonjë vepër tjetër penale. Andaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit

gjkues ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Ndërsa, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, përveç tjerash, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe faktin se i njëjti është punëtor me punë të përkohshme në Z... .

Ndërsa, kryetari i trupit gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

7. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me kusht (dënimi me burgim i kushtëzuar) dhe dënimi me gjobë,³ duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69, 374 paragrafi 3 dhe 375 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit H. R., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja armës së zjarrit e markës "...", kalibri ... mm, me numër serik

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjetë Euro) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

³ Në nenin 51 paragrafi 4 të KPRK, është parashikuar se “në rastet kur është shqiptuar dënimi me dënim me burgim dhe me gjobë, atëherë gjykata mund që të shqiptojë dënimin me kusht për te dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”.

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 6 korrik 2016

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.